



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr.809/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Tehnoburimi” D.D, me NRB: 70549778, me seli në Shupkocv - Mitrovicë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Avokat K.B. nga Prishtina, kundër debitorit “Al-Con” Sh.p.k., me NRB: 70499282, me seli në Prishtinë, në rrugën “Drenica I” nr.12, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.286/2015 të datës 05.05.2015 të Përmbartuesit Privat Fadil Hoxha me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 17.08.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Al-Con” Sh.p.k., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.286/2015 të datës 05.05.2015 të Përmbartuesit Privat Fadil Hoxha.
- II. MBETET në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.286/2015 të datës 05.05.2015 të Përmbartuesit Privat Fadil Hoxha.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrit Përmbartimor P.nr.286/2015 të datës 05.05.2015, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumenteve të besueshme – Faturës me nr.14/14 e datës 30.04.2014, nr.17/14 e datës 19.05.2014, nr.20/14 e datës 29.05.2014, nr.24/14 e datës 26.06.2014, ku e ka urdhëruar debitorin që pas pranimit të këtij urdhri t’ia paguaj borxhin total kreditorit në shumë prej 9,376.30 €, me kamatë ligjore prej 8%, nga data 05.05.2015 e deri në ditën e pagesës definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore në pajtim me UA-MD-së nr.06/2014 dhe të gjitha shpenzimet që do dalin gjatë procesit, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

Debitori në prapësim dhe në plotësimin e prapësimit të ushtruar pas afati, Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti i Përgjithshëm me aktvendim PPP.nr.642/15 të datës 28.10.2015 ka lejuar kthimin në gjendje të mëparshme për shkak të mos rruajtjes së afatit, pos tjerash ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, ashtu që faturat e lartcekura janë fiktive, rast të cilin e ka paraqitur edhe në departamentin për krime ekonomike. Më tutje ka shtuar se debitori ka paraqitur një kërkesë të përmbartuesi privat për shtyrje të ekzekutimit. Andaj i propozon Gjykatës ta shfuqizoj urdhrin përmbartimor dhe t'i abrogoj të gjitha veprimet procedurale të përmbartuesit privat.

Kreditori në përgjigjen në prapësim ka kundërshtuar në tërësi thëniet e debitorit në prapësim si të pa bazuara dhe se të njëjtat nuk qëndrojnë, ashtu që qëllimi i vetëm i debitorit është vonesa dhe shtyrja e përmbartimit. Ka theksuar se faturat në bazë të së cilës është lejuar përmbartimi i plotësojnë të gjitha kushtet ligjore dhe si të tilla janë dokument i besueshëm. Më tutje ka shtuar se debitori i ka pranuar të gjitha faturat siç vërtetohet edhe nga nënshkrimi në faturat e pranuar andaj i propozon Gjykatës ta refuzoj prapësimin e debitorit, vërtetoj urdhrin si dhe ta obligoj debitorin që të kryej pagesën e shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbartim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim*

*paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.*”, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentet e besueshme – Fatura me nr. 14/14 e datës 30.04.2014, nr.17/14 e datës 19.05.2014, nr.20/14 e datës 29.05.2014, nr. 24/14 e datës 26.06.2014; të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave është përcaktuar shuma e cila përben detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Në rastin konkret rezulton se faturat janë dorëzuar në origjinal nga ana e kreditorit dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, gjë e cila e cila vërtetohet edhe nga nënshkrimi i debitorit si dhe pagesës së pjeshme të faturave.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbartimore, vlerëson se urdhri për përmbartim i lejuar mbi bazën e dokumentit të besueshëm nuk është në kundërshtim me dispozitën e nenit 29 të LPP-së, ngase nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit siç përcaktohet në nenin 71 të LPP-së.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera te debitorit të paraqitur në prapësim, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për këtë çështje përmbartimore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.809/22, datë 17.08.2023

Gjyqtari  
Gent Bekeri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimet të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.